

Brengat e shpirtit

Qytetit tim, Tepelenes

Sa herë shëtis nëpër udhët e tua
me supet ngarkuar me këngë,
mesnatat më gjejnë të zgjuar
se hallet e tua s'më lënë

Mbrëmjet i mbruj brenda gjirit
që agimesh te çelin trendafilë
pa lodhur si guri i mullirit,
që bluan bukën për fëmijë

Çdo ditë të shohë në bebe të syrit
shoh dhimbjet, plagët, historinë,
dhe mendjen vras, pse ky i miri
te jetë binjak me varferinë?

Te shkarkoje ne preher barrën e këngëve,
ti, dorëdridhur, i përkëdhelur
e di, atje gjen veten tënde
dhe mua, te pashërueshmin rrebel

Frymëmarjen e bëjme te dy bashkë
bota po thonë, nuk ka se si
lufto të ngrohësh kockën e stërlashtë
s'e ngroh dotë unë, me poezi

Loti i brengës

C'rrjedh ashtu si askush tjetër?
dallon nga lotët e tjerë,
aq i pikur, aq i thekur,
aq i dhembshur, aq i thellë

Me të shkretën ngashërimë
më shkallmon gjirin e vrarë
më njom vargjet që sa mbirë
u rrëmben qeshjen e parë

Lot i brengës aq i shumë
me brazdon faqen, harbuar
dallgëzon e bëhet shkumë
shkumëzon e s'ka të shuar

Derdhet vullshëm, aq i sertë
me të madhe rrapëllimë
çkulmon male lart ngre det
venit shpirt e tret njerin

Lot i brengës të mos ishte
ah! të ishte lot i këngës
si shi behari do na vishte
dhe do ishte bota ndryshe

Do iki miku im

Do të iki, miku im
më lerë do t'iki larg
rëndon kjo dhimje e gjirit
si lot përmbi prag

Rëndon sikur mbi supe
gjithë malet i kame vënë
me vete do marr vajet
këtu të mbeten këngë

Me tutje, nëpër glob
agimin do kërkoj,
ia di hilet diellit,
ai nuk ngroh njësoj.

Ia di hilet diellit
ia di, miku im
përse për këto troje
dha vetëm perëndim?

Përse nuk dha dhe lindje,
përse, përse, përse?
dha vetëm lamtumirë
dhe mall për këtë dhe!

Shtizat i theu rufeja

Era fryn e çahet reja
dhe doli një copë diell,
shtizat i theu rrufeja
dhe hodha syrin në qiell

Se atje shpirtrat i kanë
gjithë ata që kanë ikur
vetëm kujtimet na lanë
edhe zemrën kaq të pikur.

Nuk e di se si durojnë
dhe nuk vijnë këtu prap,
kur na shohin që lotojmë
se kemi ngelur kaq pak.

Po ç'e bënë dhëmbshurinë
që derdhnin kur ishin gjallë,
pse e shpunë atje sipër
dhe neve nuk na e lanë?!

Përse e morën me vete
nuk e lanë që te rrijë
se prishem gjakun në deje
dhe zihemi si fëmije.

Zihemi, kush do na ndajë?
dhe behemi gazi botës,
hajdeni ju të parë,
na vini vidat e kokës!

Kohëz e shkuar

Kohë, moj kohëz e shkuar,
pse më vjen sonte ndërmend?
ti e di s'të kam harruar,
s'e harroj dot prushin tënd.

Nena ime në kasolle
ngrohte shpargërin n'oxhak
jashtë binin flokë bore,
une në djepe, njomëzak.

Permbi djep më jepte gjirin,
dhëmbshuruar, si çdo nënë,
atij gjiri, as floriri
kurrë vendin s'do ia zërë!

Nanurimë e këngës labe
nuk më ndahej asnjehere,
e golëme, nëna ime
thurte këngë, s'kishte penë. . .

Dhe këngët e saj më mbinë
kohe, moj kohëz e shkuar,
sa herë i kërkoj më vijnë
i korr e s'kanë të mbaruar.

Në këngë derdha merak

Ne këngë derdha merak,
derdha dhimbje, derdha mall,
u rrit kënga pak nga pak
do më shpjerë gjer në varr.

Mua atje do më lerë
dhe do kthehet te ju prapë
si shi behari do bjerë
gjer në gjuhë do t'ju lagë

T'ju njomë gjuhen e tharë
t'u mbledhë darkë me darkë,
t'u kthejë gazin e parë,
që hallet t'i ndani bashkë.

T'u mbledhë sofër me sofër,
se e dhembshur u gatua,
aherë do ngrini gotën,
do më kujtoni dhe mua.

Pleqtë e kurbetit

Dimrin e shtyjnë në stola të vjetër
gjymtyrët ndrydhur luajn domino
hierografe në fshat të shekullit mbetur,
pleqtë ne platinë *Pandelejmon*

Në pulqër të botës shtrydhet shpirti i tyre,
pikon i helmur në lekurë të tokës,
si lule të thara varur saksive,
mbi koka bastunësh gishtat e dorës.

Në buzën e rreshkur përtypin këngë,
e çuditshme ajo këngë'e padëgjuar,
herë ngarkuar me vaj e me gjëmë,
herë me behar të dështuar.

Dhe ngrihen e ikin ngadalë-ngadalë,
hapin e tyre askush s'e dëgjon,
pleqtë që s'dinë ku do kenë varrë,
pleqtë e platisë 'Pandelejmon'.

Më ndeze vapë korriku

Moj, më ndeze fullugan,
jap e marr e s'gjej derman,
jap e marr e derman s'gjeta,
fullugan i ndezur mbeta.

Moj, më ndeze si kaminë,
mishi e kockat, më shkrinë,
jap e marr ilaç nuk gjeta,
i ndezur kaminë mbeta.

Moj, me ndeze shpuzë zjarri,
M'u përvëlua gufari,
gufari m'u përvëlua,
mot më mot e nuk u shua.

Më ndeze, vapë korriku,
ftoh burimi, dot s'më fiku,
s'më fikin dhjetra burime,
kaq e sertë kjo shpuza ime?

Moj, më ndeze flakadan,
vdekja vjena ç'dreqin kam,
ne vjen keshtu te çdo djalë,
pse nuk vjen e të na marrë?

Vargjet rrebele

Vargjet rrebele s'i shtrokam dot,
s'i mbajkam dot në kornizat e strofës,
përthyejn konturet, uragan e shqotë,
dhe thyejn hekurat burg të portës.

Mbërthejn vetullat si mal i ngarkuar
nga bora, gati për ortek,
lëshon, zhgenjimtare, të hakërruar,
siç niset plumbi nga një dyfek.

Dhe fshikullojnë padrejtësitë në botë,
vargjet rrebel të poetit,
fshikullima e tyre është aq e fortë,
sa trondit edhe fronin e mbretit.

Dhe kanë aq shpuzë zjarri brenda,
sa llavë e vullkanit u hap udhë,
vargjet rrebele që dalin nga zemra,
vargjet rrebele që s'i shtrova kurrë.

Trëndafili nga Shqipëria

Ti erdhe largë
pa nisur të hidhje rrënjë,
në plagë të vunë një dorë baltë,
që shpirtin ta mbaje me dhëmbë.

Refugjat më trokite në portë,
dhurat shpirti nga vendlindja ime,
në baltën tënde derdha lotë,
ti u ngrohe me frymen time.

Të ngrohtë të mbolla në vazo,
në dhomë të mora atë natë,
baltës tënde iu betova,
tek ti do kthehem o baltë.

Mengjese kur iki, mbrëmjesh kur vij,
më nis e më pret me dhëmbshuri,
orët large teje mezi i shtyjë,
orët me ty, ikin s'di se si.

Udhëtove largë, trëndafili i bukur,
rrënjët i hodhe ne mallin tim,
aq thellë brenda tij janë futur,
sa dot s'i shpleksin të sjellin Perëndinë

Athine. shkurt 1999

Mos e ndiq refugjatin, polic

Ej, polic, makin shteti,
mos e ndiq atë refugjat
fuqi të vrapojë nuk ka, i shkreti
ka udhëtuar ditë e natë.

Ti as nuk e di ku bien malet e Greqisë
Ai i ka bredhur me këmbë,
Prapa ka lënë mallin e shtëpisë,
Dhe udhën e fatit ka zënë.

Në strofuj egërsirash e gdhiu natën,
Dhe ato i bënë shoqëri
Të habitura i udhën i hapën,
As sa ato nuk bën ti?

Ai ka një shpirt të butë,
Të butë si Perëndi;
S'është kriminel e as hajdut,
Përse e ndjek'o njeri.

Lëre të qetë refugjatin,
dhe për vete mos u lodh
mbi atë mos nxirr inatin
shtetarët duhen hequr osh.

Ata në karrige rrotulluese
përdridhen, top-modele në sfilatë
dhe shtojnë çdo ditë rrathë gushe
me lekët që nxirren me gjak.

Athinë-Pire, 25 maj 1998

Lule, more trima

I bukur u gdhi ky pesë maj
rrezet e diellit, përngrohin freskinë,
rrugët e lodhura nga heshtja e natës
ndën goma makinash, gjymtyrët shpjinë.

Në shtratin mëngjesor, gonxhet buzëhapura,
lëshojnë aromën për herë të parë,
Virgjëria e tyre ka mbetur mbrapa
dhe nusëria sapo u ka ardhur

Po mendja ime, fluturon e përhumbur
larg në veri, në vendim tim,
atje sot mblidhen aq shumë lule,
atje sot derdhet, aq shumë nderim.

Atje përulen përpara dëshmorëve,
që jetën, për liri e bën pre
dhe ngjiten ne eter një këngë madhore
"Lule more trima që rate për atdhe"

Dallëndyshe

Eh! moj dallëndyshe,
të isha si ti
se dimrat s'i njeh,
veç behare di.

Ti ke mall për dimër,
unë kam mall për verë,
si s'u bëme bashkë,
te dy ndonjëherë?

Dielli për ne
dihet është jetë,
ndaj ti e kërkon
a s'është e vërtetë?

Eh! moj dallëndyshe,
pranverorja ime,
ti bredh kaltërsive,
unë plak dimërimi

Eh! moj dallëndyshe
falni krahët e tua
të jem lart me ty
përgjithmon unë dua

U ndan fatet e grave

1.

Dhe u ndanë fatet,
siç e deshi zoti,
u be vendi ynë
me gra si qëmoti.

Cave u dha burrë
që vunë pasuri,
ca, që ishin shumë,
u dha varfëri.

Cave, që punuan
me ditë e me natë
nuk u dha gjë tjetër,
një copë bukë thatë.

Ca, që hardalisur
rrinin nëpër zyra,
shihni e më thoni,
në s'u ndrit fytyra.

Po si ndodhi vallë,
si ndodhi njëherë?
dihet, gjithë gratë
njësojë kane lerë.

Njësoj kanë lerë. . .
kështu them dhe unë
duron i dhe pak
ti ndaj këto punë.

Në s'i thënça mirë
shamëni dhe ju,
mos lexoni këngën
në mos qoftë kështu!

2.

Zonja pushtetarësh
u bënë ledushe,
lahen me qumësht,
i hoqën dushet.

Vaskat moderne,
prurë nga Evropa,
burrave gica
u trashet koka

fustanet varur
në kremastarë
bizhuteritë,
kush i ka parë?

Këmba mbi këmbë,
rrinë princeshat,
kthejnë filxhanët
i yshtin jevgat,

Burrave të tyre,
politikanë,
u vënë festën,
u thonë hajvanë.

dosjet që bien,
shpien në banjë
xhepat u kruajnë,

puthin paranë.

Të zestë burra,
po s'vodhën më shumë,
një lek i ikur,
një natë pa gjumë.

Në këmbë flenë,
nëpër ballkone,
në krevat dopjo,
zonjat me kone

Dhe vizitojnë
sa e sa shtete,
po mos harroni,
n'avion me vete.

Kështu që fati,
për këto gra,
mos u çuditni
s'është hata.

3.
Fshatarkat ngrihen
pa ikur nata,
lagur nga shiu,
djegur nga vapa.

Këmbët plasaritur
brazdave, ugarit
në vend të kaut
mbrehur gomarin.

Ylli i mëngjesit,
nata pa hënë,
orari i nisur,
orari i lënë.

Me *ah* e oh,
me psherëtimë,
s'dinë se ç'mbjellin,
se ç'korrin s'dinë.

Gjiri i zhuritur
gjaku holluar,
për bijtë ikur,
për hallet shtuar.

Për burrat mbetur,
nëpër kurbete,
për foshnjat rritur,
pa u bërë bebe.

Merak u mbeti,
lëmi që shinë,
sos pesë dhentë,
shitën dhe dhinë.

Dëgjuan mbretin,
dhe qeverinë,
i bënë lekë,
i shpunë në firmë.

Dhe ranë firmat,
një e nga një,
nga djersa e derdhur,
s'u mbeti gjë.

Lekët që vinin,
prej refugjatëve,

u humbi targa,
brenda një nate.

Bukën e ngjyejn,
me lot e derte,
presin gëzimet,
dhëmbjet u mbetën.

E pashëruar,
buza e çarë,
gjaku pikon,
përzihet me farë.

Kështu qe fati,
për këto gra,
ndaj dhe u thonë
hallemëdha.

Dhe u ndan fatet
jo vetëm për gra,
ca më keq për burrat,
të mjerët ata.

Morën arratinë,
dhe mbetën syrgjyn,
venë të fitojnë,
dhe lënë jetimë.

Secili më vete
ka një tragjedi;
të ngrihet Shekspiri
Ç'do bënte s'e di! . . .

Të ngrihej Shekspiri
kryevepra s'kish,
është e papërfillshme
vdekja e Ofelisë.

Fluturojë mbi krahë vese

Më hëngri merak i vjetër,
më bëri kartë cigari,
bot e qyt e s'gjeta tjetër,
si ai që ish i pari.

Në ënderrimtarët netë,
më vjen me shpirt të trazuar,
M'i bën ëndrrat fletë-fletë,
i them rri, s'ka të dëgjuar.

Fluturoj mbi krahë vese,
dhe s'besoj sevdanë e vjetër,
vesoj jetën në tre djepe,
tundur në folezën tjetër.

Përmbi djepe buza mbetur,
lule shege në pranverë,
ik, mor ik, merak i vjetër,
e kam mbyllur atë derë.

Natën e borës së madhe

S'e mbaj mënd se ç'të kam thënë
natën e borës së madhe,
kur me naze, zonjë e rëndë,
shkove mes për mes gjahtarëve.

Te derë e stanit më shkove,
ndënje pak sa more frymë,
syrin bukur rrotullove,
pastaj more arratinë.

Dy shkarpa i hodha zjarrit,
u nisa, tu qepa prapa,
djersa më mbuloi ballin,
sikur pikun kishte vapa,

Gjurmët bora t'i mbulonte,
flokërendë, aq e bardhë,
kishë një shenjë gjurma jote,
s'e njihje njeri mëradhë.

Kish një shenjë, tregon udhë,
për atë që doje vetë,
ndaj s'më shkau këmba kurrë,
në ata shtigjet e sertë.

S'e mbaj mend se ç'të kam thënë,
natën e borës së madhe,
n'atë pyll ku zanat flenë,
djersën e ballit më thave.

Vetullushe në më do

Mos ma nxi rrethin e syrit,
vetullushe në më do,
lërmi flokët si floriri,
që të luaj pak me to.

Lëri që të derdhen vetë,
Palë-palë si ata,
në ndonjë tek unë mbetë,
atje lëre, mos e nga.

Mos e nga, lëre të rrijë,
përgjithnjë atje ku ra,
lotin syrit do m'i fshijë,
se, më të butë për detin s'ka

Mos e nga se dashuria
do mbërthej shpirtin tim,
si një lule burbuqepsur,
për të çelur në agim.

Djepet e Bajronit

Si e gdhive atë natë
thuj Mesolonjë, -ta di,
ç'drithma pati ai shtrat,
ç'ngashërma pate ti?

Ai shpirti yt mësuar,
nëpër luftra famëmëdha,
që kaq djem i kish varrur,
pse s'duroka sonte, çka?

Ai shtrat ku ule kokën,
dhe nderove një poet,
edhe sot i ruan lotët,
edhe sot është kaq i nxehtë.

Se Bajroni kish tre djepe,
të parin kish në Angli,
të dytin në Tepelenë,
dhe i treti ishte ti.

Për atje zemra më dhemb

Ti moj era shpejtërore,
pse s'më merr në krahun tënd?
Shpjermë në ato male bore
për atje zemra më dhemb!

N'ato majat kreshpërore,
ku e gjej vatrën të ngrohtë,
ku mbi varret stërgjyshore,
derdh me mall një pikë lot.

Fjalëmbël kënga derdhet,
edhe derti, kuje madh,
këmbë e malit përkëdhelet,
në të kaltrin det të saj.

Ku përroi vrullshëm niset,
i bufatur nga rrëketë,
edhe zalli i tij zaliset,
tek përplasat breg më breg.

Ku lulojnë lulëria,
nga lëndina gjer në shkëmb,
gërshetdredhur vajzëria,
fafurinjë, të lënë pa mënd.

Atje dua të më shpiesh,
ti dorëbuti zefir,
ballin atje të ma ngjyesh,
më shëron e bëhem mirë.

Tek rritet bredhi pa rrënjë

Tek puthet mali me renë
thëllëza me trëndelinë,
tek ka shqijonja folenë,
atje kemi Labërinë.

Tek thyen shtizat rrufeja,
Mu në presë të jataganit,
tek shtrihen gunat mbi tela,
tek zbukuron plumbi ballin.

Tek gdhend koha trimërinë,
derdhur gjakun valë-valë,
tek falën djemtë rininë,
tek kemi varret e parë.

Tek i thonë këngës, këngë,
dashurisë, dashuri,
tek rritet bredhi pa rrënjë
atje je ti labëri.

Kënga e Golëmes

Na djeg malli, moj Golëme
kraharorin na sfililit,
na hap plagë, na jep dhëmbje
det i thell, malli yt.

Na rrëmben me ato dallgë
na mbulon me dhëmbshuri,
bëhet ëndrra nëpër natë
i lë vreshtat, vjen aty

Dhe tek jemi nëpër botë
që të gjithëve na kërkon
buzëqesh e na ter lotët
përkëdhel e na shëron.

N'atë prehër beharuar
na mëkove , na dhe jetë
N'atë varr lulembuluar
si duron e nuk na fletë.

I derdh dertet e rënda
dhe atje dergje e qetë
"hëni, u keqe Golëmja,
se u lashë det e tërmet"

Pa pushuar, prushi i gjirit
moj e mirë, na zhurit
i përjetshëm guri i varrit
i përjetshëm shpirti yt.

Ti ike larg

T ike largë edhe më le
në mes të udhës, ne mes të gjolit
të ndiqja rrugës, s'dija nga qe
se pluhurosor ishin horizontët

Ti ike largë dhe s'u kujtove
shpatullat i ktheve një zambaku
një vashe tjetër iu përgjërrove
në skuta qesh tani së largu.

Ti ike largë e nuk u ktheve
dhe kurrë mos u kthesh më
kur qielli të ulë kreshtat e reve
një pritë vetëtime do të zë. . . .

Maria

E bukur është Maria
yll i këputur me hënë
shohin ëndrra djemuria
ngrihet gjumit si të lënë.

Kur Maria më bën tutje
lënë sorkadhet lëndinat
thëllëzat në ato lugje
më meken nga psherëtimet

Burimin lajthisë marrë
derdhur gushës aq të bardhë
sumbullave gjirit rarë
kush piu s'u bë i shkalë?

Brenda syrit një copë qiell
te Maria qe ngjuar
vesa sa puthur me diell
përmditë buzë përvëlur.

E bukur Maria
e bukur gjithë lezete
një natë me të të flija
nuk do flisja me vete

Sheshi "Omonia"

Një det i tërë njerëzish
por i gjuhëve aspak
një det i tërë dhëmbjesh
veç kënga aq largë

Dashuri të thërrmuara
shkërmoq nëpër kohë
zemra të coptuara
plagosur si ato

Dhe mall, sa shumë mall
sa kraharorët nuk e nxënë
sikur gjithë lumenjtë tanë
kanë dalë, shtratin të lënë

Veç gjuha shqipe në "Omonia"
mbretërore, mbretëron
Naimiana, është e jona
na mbledh rrotull, na bashkon.

Dhe na shpie, ku s'na shpie
tek na gjen shpirti rehat
n'ato vise Shqipërie
tek na duket dheu mjaltë

Athinë, Qershor 1998

Ra një vesë

Ra një vesë, u vesua
gjithë vendi rreth e rreth
ra një rreze, u prarua
një lëndinë, një mëngjes.

Hodha syrin m'u verbua
tej në ledh e përkarshi
rri një vashë, çka me mua?
ç'dreqin ka s'e nuk e di

Lëviz vetullën harkuar
prapë e lë roje në sy
gërsheti nepërkë harbuar
vete çlodhet përmbi gji.

Njom vështrimin nëpër vesë
di ç'kërkon e di se ç'do
them të vete a të presë
që të vijë ajo vet?

shpresëshuar marr me vete
gjakun valë që zemra ka
se kam bredhur nëpër dete
ndaj di vala ç'dhëmbje mba.

Pa i fola e më foli
lulet vesën kishin pirë
m'u gufua kraharori
s'mbante dot dallgë të tillë!

Ditën që të bëhesh nuse

Ditën që të behët nuse
ti e di se ç'do bëj
gjithë lulet e qershise
dhe ne vjesht do ti gjej.

Kokrrat e saj gjakushe
vath në vesh do t'i var
për gjerdan të asaj gushe
luleshqer do të marr.

Dhe për vellon, tis të hollë
do t'i them vesës të vijë
syri im kur ta vështrojë
unë e di që do ta shkrijë.

Ditën që të bëhesh nuse
s'do jetë tjetër si ti
sepse vash veç njëherë
mund të bëj nusëri.

Labërise

Më bëre thirrjen e gjakut
dhe unë erdha tek ti
m'i hoqe gjakut farmakun
bëre mirë, Labëri!

Gjaku im harroi varret
harroi ku kishte rrjedhë
harroi krojet e stanet
dhe u bë këmborë e çjerrë.

Gjaku im, o Labëri
harroi rrahjet e zemrës
sa më shumë paralli
aq më pakë, i biri i nënës.

Zëri yt, o nëna ime
që më dha sisë në djep
prapë s'më flet i ashpërsuar
prapë më thotë, si je poet?

Ti më thirre, Labëri
djepi im i dhëmbshurisë
po ç' nuk mora unë nga ti
moj e sertë, moj e zgjuar!

Plasi Vlora ulërimë

Gjarpëri me vërshëllime
kur shkoje shkelje me sqimë

Qimet mbi supë s't'u ngjinë
haheshe me vetëtimë.

Pak të panë, shumë të njihinë
brodhe shtetet, fqinjë më fqinjë.

Hatajet, po të godinë
plasi Vlora ulërimë.

Radhë-radhë te porta vijinë
duan të të shohin synë.

Se u rrushkullove gjinë
duan të të shohin synë.

Mjerë Vitua, Megi mjerë
gonxhja që sa kishte çelë.

Mjerë gjithë ajo derë
si Maloshi, s'ka të tjerë!

Më thua ngjaj me Shqipëri

"Vajzës së djalit tim, Benitës së vogël "

Ti erdhe në jetë, kur vjeshta verdhonte fletët
dhe dallëndyshet bëheshin gati për udhëtim
cicërimat e tyre puthnin mëngjeset nxituar
cicërimat jote puthte pranverore shpirtin tim.

Shpirti im në qerpikë të njomur
me gjyshen tënde vështrohesha në sy
midis nesh ti, Benita e vogël
që vërtetësisht ngjake me të dy.

Gjyshja më thotë ngjan nga nusja
nga djali ngjan, i them unë
në sytë e saj, çikëlon shpuza
dhe buzëqeshja derdhet në buzë.

zgjat doçkat e tua qumështore
të dyve na përkëdhel siç di
si flutur e bukur krahëbore
na derdh beharin në shtëpi.

Dhe mëndjen shtrydhim ditë për ditë
me cilin ngjason më shumë ti?
ti miset e globit i venit
më thua, ngjaj me Shqipëri!

Tetor 1999

Atë djalin tim ç'e gjeti

O ju djem, që çatë detin
si zogjtë në tramundanë
atë djalin tim ç'e gjeti
sytë tuaj mos e panë?

Mos e panë sytë tuaj
amani u keqen nëna
një copë letër të shkruaj
se pa gjakun nuk rreh zemra.

Po më iku nëpër natë
hodhi këmbën valë më valë
më tha që do kthehem prapë
sa nuk vjen, nuk është i gjallë.

O djem, gëzofshi rininë
në e pafshi atëhëna
thoni një natë të vijë
thoni të ka vdekur nëna.

Do më shpihen eshtrat

Më kërcasin eshtrat nga pesha e halleve
kaq shumë shtati s'u mbjatka dot
u dashka të kesh gjunjët e maleve
dhe detet e dheut për lot.

U dashka të kesh zemër të stëralltë
që trompozat në vena t'i thërmojë
ligësinë ta lërë nga dejet jashtë
mirësia në ta, të vërshkullojë.

U dashka shkarkuar balli i rënduar
që vetullat të nderen ngadalë
mendimit që troket harbuar
t'i zënë pritë, të mos dalë.

Pritë t'i zënë mendimit inatçor
vështrimin te Perëndia ta shpien
pa siç shkarkohen malet nga dëborë
dhe eshtrat një ditë do më shpihen.

Bëhu mbles o fllad

Doli ylli në sabah
mugullira sa u ça
vesa përmbi lule ra
i puthi, s'bëri shaka,

I puthi si lum ajo
që ka fatin fle me to
aman fllad, mos e ngacmo
se ikën e më se shoh

Lulet erërat buronjë
çuçurisin seç i thonë
ti në i dëgjofsh tregomë
bëhu mbles ne dertin tonë.

Bëhu mbles o fllad behari
ti e di sa më djeg zjarri
ti e di sa më tret malli
ti e di sa heq qyqari.

në s'u bëfsh, thuajm pse
pa i vete vetë më nge
të bukurën përmbi dhe
e kandis me pak hile.

Shkon një vash

Shkon një vashë, s'flet një fjalë
lartë e poshtë me fund të çarë
trokas bastunin në shkallë
nga inati që s'jam djalë.

I them syrit, s'je në vete
pse s'e mbyll ti, o qerpik'
ç'dreqin ke që atje vete
është punë me rrezik.

Unë e mbyll, -më tha qerpiku, -
po syri është qoti
jo se e bën përsëligu
po pa parë dot nuk rri.

Kur të thotë vasha. . .

Kur të thotë vasha, hajde
përse derdhe si veriu?
kalon ledhe, thyen gardhe
dhe gëzon zemra vetiu.

Kur të thotë vasha, prit më
le kërrabën, harron shtigje
si guri në rrokullimë
fluturon mbi ato brigje.

Kur të thotë vasha, delmë
e lë stanin vetëtimë
e lë pa mjelë kopenë
dhe vete e zë pusinë.

Kur të thotë vasha, të dua
fërshëllen e s'lodhe këngë
kështu më ndodhi dhe mua
një natë maji me hënë.

M'u zhurit fare gufari
M'u prenë të shkretat këmbë
ajo lastonjë behari
mu më gji më kishte rënë.

Na duhet besa

Ku është besa jote
ku është, Kostandin?
u ngrite nga varri
për një Doruntinë.

Ngrite përmbi supe
amanetin mal
fluturon e s'ndale
hipur mbi një kalë.

Po tani ku je
ku je, Kostandin?
unë jamë i shkalë
a ti s'di ku mbin?

Ku është besa jote
o Ago Imeri?
mbeti nëpër kohë
brezit tim s'i erdhi.

Mbeti në baladë
përthyer, zhubrosur
se ky brezi im
qenka i marosur.

Po ngrihuni prapë
hipni përmbi kuaj
sa na duhet besa
si në kohën tuaj.

Kënga e lypsit

Fryn erë e veriut
të plevitos gjinë
mjerë, ti, i mjeri
dora jote shtrirë.

Fryn are e lumit
të përloti synë
mjerë, ti i mjeri
mjerë sa jetimë.

bie për të fjetur
lagur e mërdhirë
mjerë, ti, i mjeri
dora jote shtrirë.

dhe një ditë s'dole
të gjetën të ngrirë
mjerë, ti i mjeri
mjerë sa jetimë!

Nuk shterr kurrë mirësia

Në syrin tënd, shoh jetën
detin e thellë, qiellin e kaltër
trëndelinën te floku tretur
mëngjesin që largon natën.

Në buzëqeshje një verë e tërë
verë si kjo nuk kisha parë
veshur me lule, larë me hënë
loti në sy margaritar.

E kaloj lotin brenda gjirit
dhe dridhet zemra si e zogut
sa larg, sa larg që jemi
sa afër, të gjithë së toku.

Veç dashuria është e njëjtë
se ajo një rrënjë ka
kur mbillet mirë mbetet e shenjtë
kur mbillet keq, shpirtin të ha.

Po shpirti yt është aq i thellë
në dimensionin njerëzor
sa kurrë mirësia s'do t'i shterrë
si gurrë mali do burojë.

Grupit të Lapardhasë

Kulloi bora në male
dhe thëllëza ujë piu
lau grykën këngëtare
dhe nisi këngën vetiu.

Kënga më ulet në prehër
si mëngjes përmbi lule
Lapardhjotshe aq e ëmbël
dhe dalldiset dhe përkundet.

Më përthan plagën e shpirtit
degdis vapën e korrikut
bie mallin e Nazifit
kthesën cule të Golikut.

Si puhisë ledhatore
përkëdhel zë i Meleqit
bie zjarret stërgjyshërore
nanuris ëndjet e djepit!

Nuk rri dot pa më ngacmuar
zilia që kam burimit
gjirin tim me sherqe shtruar
bejtet e Feti Brahimit.

Më magjeps isua legjend
si pylli me fëshfërimë
zogjtë i vë gjumë të flenë
dielli pa fshehur synë.

Më rrëmben me krahët era
nëpër netë, nëpër ditë
ulemi pimë kafënë
"Tek shtat pusët në grykë"

Sabaudin Shehut

Të mori me vete kjo mbrëmje, o Bacë
e paemër do ishte po të ikte pa ty
donte që bashkë me diellin e zjarrtë
të kishte dhe shpirtin tënd në gji.

Donte që t'i mburrej mëngjesit
kur trupin e listë të vesonte
donte me lot në sy t'i shinte njerëzit
dhe nëpër mallkimet e tyre të shkonte.

Donte që shpirti yt të bëhej dritë
të ndriste errësirën e saj
s'e dinte që do merrte gjithë mëritë
dhe emrin natëkorbë paskëtaj.

Se shpirtin ti e kishe lënë
te njerëzit, te kënga, te jeta
ndaj pena më qënka kaq e rëndë
dhe kaq i vogël më duket vetja.

Kufijtë mërgimtarë do t'i gris
dhembjet e tyre Zoti t'i durojë
një lot të nxehtë me zogjtë do nis
mbi varrin tënd të pikoj.

Dimërin ku do ta gjes

Dimërin ku do ta bësh
sa ra borë nëpër male
vërrinë ku do ta gjes
as më thau, moj sorkadhe?

Do më zbresësh në korie
ta lësh limerin e vjetër
edhe pranë një selvie
do ma ngresh limerin tjetër?

Po limeret e selvive
nuk të sjellin prapë në jetë
hilet mbajnë ndenë hije
se duan të duken vetë

ndaj selvia jeton shumë
se e mbjellin nëpër varre
jetë të vdekurish në rrënjë
në gjethe sytë e të gjallëve.

dimërimin ku do ta bësh
sorkadhja qafëpurterkë
vërri më të mirë do gjes
se tek unë, moj sorkadhe?

E kërkova shpirtin

Shpirtin e kërkova
tejendanë në botë
kot lodhe më thanë
se nuk e gjen dot.

Shpirtin e kërkova
në qiell e dhe
kot lodhe më thanë
se nuk është atje.

Shpirtin e kërkova
në përjetësi
kur iu përgjërova
tha "Më ke në gji. "

Më afër s'të vinë

-Moj e vogla kumbullore
ku të zuri nata?

-Atje tej në ato shtigje
se më humbi napa.

-Atë napë gushë bardhë
vij e ta gjej unë
-Mos e merr udhën, o djalë
se na hapet punë.

-Në s'e gjetsha menjëherë
do kërkojmë bashkë
-jo, se s'ka natë në verë
dhe gdhieni jashtë.

-Në u gdhifshim s'ka më mirë
vesa do na zërë. . .
-jo, se lag buzët e gjinë
dhe rehat s'më lënë.

-Në u lagshim t'i thaj vetë
me një trëndelinë
-pse hidhe degë më degë
më afër s'të vijnë.

U zura me gruan

U zura me gruan mbrëmë
natë e sertë, natë ters
thashë t'i hiqja një pëllëmbë
po mbeti udha në mes. . . .

Dorëthari nuk e bëra
"kush do bëhej gaz i botës?"
i mbledha plaçkat të tëra
hapa kanatën e portës.

Derëshuari me ujë
që nuk bëra katandi
para trokë e pas rrëmuje
fëmijët një lukuni.

Ç'faj më kish ajo e shkreta
që punonte sa për dhjetë
ngrihej e flinte si bleta
unë mbetur shark i shkretë. . .

U zura me gruan mbrëmë
sos vërtet bëra atë!
një gjumë më paskish zënë
ishte ëndërr, s'ishte gjë.

Ju betohem s'kisha pirë

Për një hap që s'hodha mirë
bëra këmbën copë-copë
ju betohem s'kisha pirë
po syri s'e ku kullot.

Paskej gjetur një njomishte
duke bredhur si azat
atje mbeti, faj nuk kishte
po më la mua sakat.

Ç'qe plaga që mori këmba?
u them unë, s'ishte gjë
thellë-thellë rënkoj zemra
shpërmë të njihem me të.

Dhe u ngrita çalë-çalë
thashë me vete ç'të bën syri
e lë shpirtin kaq të vvarë
provojeni të ma dini.

E përpusha shpuzën

E përpusha shpuzën
me urën e zjarrit
lëshon çikëndia
zgërbonjë e përrallit

Ngrihen çikëndiat
puthin njëra-tjetrën
më duket oxhaku
si një botë tjetër.

Më duket oxhaku
si një copë qiell
një yll i këputur
një mijë shpërthyer.

Një yll i këputur
përmbi vatër rënë
një vaj i sa nisur
një këngë sa lënë.

E përpusha shpuzën
me urën e zjarrit
kur ikin nga jeta
me vete çfarë marrim?

Vdekja

Pse te vdekja vete mendja
se s'e dimë si do jetë?
nuk besoj se është si mbrëmja
se pastaj do kish mëngjes.

Prushërohet në vetmi

Kur vret gjahtari sorkadhe
ajo kokën nga e kthen?
thonë diellit i falet
një lot në sy i shkëlqen.

Loti nuk pikon i gjithë
dielli pjesën s'e lë
toka mundohet ta thithë
dhe nga loti s'mbetet gjë.

Toka si një nënë e mirë
lulet nga gjiri i nxjerr
e mbush plot atë lëndinë
se sorkadhja më s'i vjen.

Ashtu dhe me dashurinë
atë dashurinë e parë
kur e vrasin pa mëshirë
si sorkadhja zë e qan.

Fshihet thellë-thellë në zemër
dhe askush vendin s'ia di
dhe pse ka të bukur emër
prushërohet në vetmi.

Sevdaja

Kjo sevdaja paska punë
të lënka netëve pa gjumë
të ngjitka përjetë shpatit
të bëka gazin e fshatit.

Kjo sevdaja, s'di ç't'u them
e kërkon e nuk e gjen
ta mat shpirtin me dehrem
e largon e ajo vjen.

Sevdaja të dhënka zemër
të përkëdhelka ëmbël
të bëka të shohësh ëndërr
sikur vashën le në prehër. . . .

Sevdaja qënka çudia
unë, i mjeri nga ta dija?
në grackë të saj do bija
kish urdhëruar Perëndia

Një natë. . . .

Një natë se si jam gdhirë
natë prilli, s'ishte një
binte shi e bënte mirë
zbruhej lëndina me të.

Zbruhet dheu e merr jetë
dhe për vete nuk e mba
e thërrmon në mijëra pjesë
ushqen supin gjithë ç'ka.

Midis diellit e dheut
një besë, kur kanë lerë
njëri rrënjët, tjetri lulet
kush më shumë t'i përkëdhelë!

Dhe kështu me ne të gjithë
rrënjët mbeten po aty
lulet ikin, udhëtojnë
atje lart, në Perëndi

Vasha e ëndrrës

Do venitem, nuk marrosem
mendjen në vend do ta mbaj
nëpër dimra nuk cingrosem
do më ngrohë frymë e saj.

Cingërimën dimërore
afshi i saj do ta fashit
ajo vashë, lule bore
nëpër ëndrra m'u fanit.

U faneps e s'ka të ikur
prushërore, prushëron
ajo buzë e saj më piku
dhe më qas, dhe më largon.

Më kapite vashë e ëndrrës
më kapite, po s'e them
ditën që të bëhesh nuse
nuk a di a do jem?!

Ishullit të Sazanit

Fëmijë i vetëm je, o Sazan
deti të lag, erërat të përkundin
mëngjesesh zgjohesh si një sulltan
dhe ha inat me Karaburunin.

Të drejtë ke, të la të vetëm
atij kep i flasin dhe tani
kurse ty, si rrallë tjetër
të vunë emër si njeri.

Atë ditë që fole vetë

Dalëngadalë, kur u rrite
kur u bëre për në kalë
si kaluan këto vite
si kaluan pa të parë?

Unë të dija vogëlushe
një keçe që kërcen lehtë
po ti syrin e rrëmbushe
atë ditë që fole vetë

Ajo buzë trëndafili
dridhej, dridhej pa pushuar
sa më shumë hidhej syri
aq më shumë mirr të skuqur.

Të kuqtë i ngjitej faqes
siç ngjitet lulja për shkëmbi
dora nisej e nuk zgjatej
ç'dreq ka dora, kush e trembi?

Ç'dreqi ka dora që dridhet
nuk më thoni që ta di?
kush e ka mendjen te vitet
kur fut shtërporen në gji?

Thonë . . .

Thonë mos e pi rakinë
se rakia nis shpejt. . .
po të kishte qenë e tillë
s'do mbetej asnjë poet!

Thonë, mos u bëj jaran
do mbetesh më ndonjë gardh
po ikin burra të mirë
dhe jaranët mbeten pas.

Thonë po bëre zarare
nuk ke varr, o i uruar
varret, grevë s'bënë kurrë
s'lanë njeri pa mbuluar.

Thonë që na ngrohte shpirtin
me ato vargje që shkrua
ngrohuni, se mua shteti
Kolonjare po më rruan. . .

Ku janë rrënjët e syrit

Ku janë rrënjët e syrit
atij syri që flet shumë
që ka ngjyrën e ullirit
a të valës larë shkumë.

Ku janë rrënjët e syrit?
doemos s'i ka ai
diku tjetër është burimi
i fshehur thellë në gji.

Rrënjë e syrit është në zemër
ndaj dhe syri flet aq shumë
ndaj kur shkelet, shkelet ëmbël
dhe kur shkelet të hap punë.

Do të kërkoj hapësirë

S'më bëjnë përshtypje këta pallate
më duken si gurë zalli të bardhë
jeta brenda tyre më shfaqet
anemike, nga zhurmat e makinave vvarë

Muskujt e jetës të qullosur
shtrihen në lagje anembanë
sytë nga pagjumësia mullosur
duken kandil të hedhur mënjanë.

Syri im kërkon hapësirë
me hapësira është mësuar
s'është faji im, moj Athinë
mushkritë, vendlindja m'i ka zgjedhur.

Ndaj do iki këtej sa më shpejt
sa fryma të mos më jetë zënë
do kërkoj hapësira përreth
të ta shoh madhësinë të tërë.

Malli i ndarjes

Po të shkretin mall të ndarjes
ati ynë, përse e dhe?
pak kishte njeriu halle
i mbarojnë veç atje?! . .

Pak halle kish njeriu
përmbi supet plagëruar
përse të qajë çilimiu
këtu vetë e ke dërguar?

Pse ndahet djali me nënë
dhe vëllai me vëlla?
ikin vashat, brengë lënë
ikin motrat s'di se nga. . .

Dhe mes tyre i përjetshëm
malli i ndarjes, ah, o Zot!
më të dridhshëm s'ka mall tjetër
më të prekshëm, më me lot.

Malli i ndarjes, malli i ndarjes
cili nuk e ka provuar
hidhni sytë nëpër varre
nuk duken të dhëmbshuruar.

Shkon mbi lule a mbi mua?

Vashëza, thua më thua
shkon mbi lule a mbi mua
fladite krua më krua
as më jep pak veri hua
po s'më dhe veri se plasa
gjurma-gjurmës mos t'u ndafsha.

"Të plasësh, mos e marsh beharin
etur si nepërka malit
t'u mpiftë balukja ballit
po s'puthe mua të marrin
po s'bëre si të them unë
rënsh e mos u ngrefsh në gjumë"

Dora shtatë byzylykë
shtatë gjerdanë në grykë
përmbi ta m'u shkoqën sytë
s'mbahet loti në qerpikë
ç'paska loti shtatë palë
ç'ka që derdhet kaq i valë!?

Ç'ka që derdhet kaq i valë
nëpër mollëz duke shkarë
pak anën e buzës marrë
përmbi gjëmë paska rarë
përmbi gji më paska rënë
plaça unë që dhashë nëmë!

Një darkë në një sofa

Plaka, plakave u tha
një darkë në një sofa:
-Kam një nuse, mashalla
të bukur e për sevda.

Të bukur e naze shumë
i mbete gazi në buzë
flutur kur vete në punë
kur me kthehet, lumthi unë!

Kur kthehet, rrëmben xhezvenë
me ajkë ma bën kafenë
bën një kafe për bejlerë
s'keni pirë tjetër herë!

Më rri qiri në këmbë
"lepe-peqe, ç'do moj nënë?"
zunë plakat mërmërojnë
njëra-tjetrën e vështrojnë.

"Hesht, adha, -i thanë gratë-
se ti ngrihesh që me natë
nusia shtrirë në krevat
ti shkarkon barrën me shkarpë.

Merr xanën e fshin avllinë
vë saçin e heq kusinë
ushqen lopën, lëshon dhinë
sa theve dhe dy-tri brinjë.

Pa këto nuset e sotme
le të jenë dhe të sojme
hidhen e dridhen si çope
hundën si majë kokojke.

Nuse kemi qenë vetë
punonim sa për një çetë
pa le kur na flisnin pleqtë
dridheshim pors i purtekë"

I dëgjon nusja te dera:
"Ç'lafosni kështu, moj vjehrra
se ishin kohë të tjera
atë kohë u zuri hera.

Kur të bëhemi dhe ne
si ju me ballin me thinja
ato ditë që do vinë
s'do na duken aq të mira"

Paguri me dhallë

Një pagur me dhallë
e merrja në punë
i vija një koçkël
kërkonte më shumë.

E varja pagurin
në një degë gorrice
sa zinte pak vapa
koçkëli lëvizte.

Sa ngrohej paguri
koçkëli përpjetë
dhalla zbardhte fletët
dhe thante një degë.

Ndaj nesre e varja
në një degë tjetër
sa kur hodha sytë
gjethe nuk kish mbetur.

Përvjashëm gorrica
fliste duke qarë
më mpiu në palcë
mos pikoftë dhallë.

eh, gorricë e shkretë
mendja nuk më vate
se ty do të thante
mua do më mbante. . .

Gulçojnë yjet. . .

Gulçojn, yjet, gulçojnë
po hënën, dot nuk e zënë
mijëra netë ëndërrojnë
një natë me të, të flenë. . . .

Malli i burimit

Përse s'të merr malli në kohën time
për sitën e bardhë, për natën intime
për djalin e vrarë, për foshnjën jetime
pranverën pa ardh, dimrin e cingrive.

Për setin me valë, për fushën me lule
për miken e parë, për stanin që shkulet
për jetën e tharë, për nënat kërcure
për gjethen pa rarë, sa nisur verdhulet.

Për vashat lastare, që vinin çdo mëngjes
për vështrim të syve, ata sy të zezë
për dallimë të gjinjve, që më ranë në pjesë
për një drithërimë, ta ndej mezi pres.

Për një gurgullimë, në një natë shtruar,
për një fëshfërimë fustani, harruar,
për një buzë të plasur, dashuri pikuar
për një fërfëllimë, pritur mosduruar.

Për emrin që kisha, si burim i parë
ngopeshin thëllëzat, unë s'kisha të tharë
vinin vashëria, ftohnin gushë e ballë
thomëni dhe ju: Nuk i thoni mall?

Gërsheta

Qe një e bukur gërshetë
binte përmbi gushë
binte lehtë përmbi gushë
e puthja më ndizte prush.

Qe një gërshetë e florinjëtë
kur s'kish hënë, dil të ndritë
del e ndrit, kur nuk ka hënë
e ngasin, po si ta lënë?

Qe një gërshetë nepërkë
nëma ime mos e zëntë
mos e zëntë ajo nëmë
se do them, që s'e kam thënë!

Kush tha. . . ?

Kush tha që vdiq Nastradini
ka më Nastradin se yni?

Ç'ishte gruri në litar?
ky në pe e mban të therë!

Ç'janë dy behare bashkë?
ky i bëri pesë a gjashtë?! . . .

Ç'është nga tava ikën pula?
ky surrat gri pëllumba.

Ç'është të kesh një gomar?
ky vë një tabor në radhë

Ç'është një lepur të zërë?
ky lepuj i ka të tërë.

Ç'është të jesh efendi?
ky vetë xhelat e vetë kadi.

Nuk dremis. . . .

R. Bernsit

Nuk dremis në këngët e tua
nuk lodhem me vargun e shenjtë
ti skocez i përvëluar
ç'shkrove, i kishe në shpirtin tënd.

"Gjëmon dashuria, mes gjakut të valë"
kush s'ta njihje zjarrin thoshte është i shkalë
pse nuk merr parmendën të punojë ugarë
po mbeti përjetë me barkun e tharë.

Bërnsi nuk ditkej, ç'është dashuria?! . .
tre shekuj të shkuar tek ai do vija:
tre shekuj të ikur, dhe dhjetra të ardhur
atë do ta gjeja, në vargë të pazbardhur.

Kishim kohë. . .

Kishim kohë që nuk rrinim
kishim kohë që nuk vinim
ditëve inatin pinim
netëve gjumë nuk flinim.

Ç'ishte ky inati ynë
shtyp si gur në rrokullimë
s'prishëm kishën, as xhaminë
dy fjalë u zgjatnë e ngjinë.

u zgjatën dy fjalë, ç'qenë
u ngjitën e nuk u ndanë
hapën përrua të thellë
s'hidhej dot anë më anë.

Veç një ditë se si erdhi
buzët të ngjita në gushë
syri më treti ylberin
sikur e ngjeva në shpuzë.

Për ditën e verës

Për ditën e verës
thura një verore
tre ngjyra ylberi
byzylyk për dore.

Tre ngjyra ylberi
të verdhë e të kuqe
doemos së bardhës
s'i thosha dot tutje!

S'i thosha dot tutje
do derdhej për gjiri
atje, moj xhanushe
do më mpihet syri.

Të kuqen për faqen
të bëhet thanushe
të më përvëlojë
kur të bëhesh nuse.

Të verdhën për flokët
që varen mbi supe
se më bien vjeshtën
tek ajo baluke.

Për ditën e verës
të thura verore
s'pret për verën tjetër
mikja bardhullore.

Violonist Fejziut

Syrin vetullor, shtrirë përmbi tela
këngën e përpushte, e rrëmbente era
harkun që londronte, dora si e mbante
nëpër shtigje dite, nëpër terre nate.

Zëri gurgullimë, vallë, si e ktheje
lërje pas burimet dhe para i gjeje
lërje dashurinë, shkreheshe në vaj
ç'kishe ajo violin, ëngjëj apo djaj?

Ç'kishe ajo violinë, që s'më hiqet mendja
një mijë Paganinë i kishte përbrënda
dukej një orkestër, ishte vetëm një
bjeri dhe një herë e nuk dua gjë!

Bjeri edhe një herë, ti jevgu Fejzi
ata pesë tela, det më dhëmbshuri
përmbi varrin tënd, sot ka mbirë bar
përmbi violinë, kënga s'është tharë. . . .

Si duroj. .

Më sfilite, më zhurite
më godite, më drobite
more zemrën, më venite
more shpirtin, s'më le vite
si duroj?

Më qëlllove vetëtimë
më rrëmbeve, dashurinë
në një çast thinjat më mbinë
kur më le në rrokullimë
si duroj?

Faqeçjerrë dal në derë
gris mëngjeset, besëprerë
mallkoj vjeshtë, mallkoj pranverë
mallkoj diellin sa lerë
si duroj?

Më nxirose, më mjerose
sa më nise, nuk më sose
më cingrise, më përdhose
i mallkuar si më joshe
si duroj?

O nëmur, i harruar
shpirtkatran i përçundnuar
s'desha dimër, desha verë
mos të qeshtë buza njëherë
do duroj!

Lë selvinë, vjen tek unë

Një bilbil në një selvi
çdo mëngjes aty vjen rri
i derdh ligjet si njeri
ç'ka një brengë, nuk e di.

Ka një brengë, që tretë
mbreti i këngës nuk u lodh
s'u lathit e nuk u mek
edhe zëri nuk iu drodh.

Avazet e tij më ngrenë
si t'ia bëj, a unë e mjera
vete i hap penxherenë
sa çelur sythin pranvera.

Desha t'i japë një pikë ujë
për atë grykë longari
-Mermë-tha-në atë buzë
se lumturohet gjyzari.

Dhe në buzën time flakë
e freskoj atë buzë
unë prisja të përvëlohej
ai puthte dhe më shumë.

Hap pexheren për çdo natë
dhe selvinë lë bilbili
hapen ca fjalë në fshat
s'ke se ç'bën, kështu vjen prilli. . .

Do të vijë më e malluar

Valën si palë fustani
në e pafshi, mos ma ngani
dhe nga deti mos na ndani
inatin me mua mbani.

Se kur vjen e shkumëzuar
bregu pret i merakosur
do sosit tek ai vallë
apo do kthehet pa sosur?

Dhe kur vala s'arrin dot
dorën zgjat ta kap nxituar
mos nxito, vala i thotë
do vij prapë më e malluar

Mijëra jetë dashuruar
mijëra jetë ndarë prapë
edhe puthur, dhe duruar
kurrë ftohur, ndezur flakë!

Kanarinës

Të mbyllën në kafaz
"kush dreqin e shpiku"
kanarinë e bukur
liria të iku.

Ti u hidhërove
s'do përkëdhelitë
e dije, kur mbyllën
s'hapen më kuvlitë.

Ata që të mbyllën
donin të këndoje
ty s'të dilte kënga
vaje ligjëroje.

Njerëzia thonë
këndon kanarina
gjuhën nuk ta dinë
janë psherëtima.

Përmbi ballin aq të bukur

Pse të thonë Sofo Labi?
se ke rrënjë Labërie
rrënjë të thella si rrapi
që mbi supe shekuj thyen.

Përmbi ballin aq të bukur
hapur gjirin mirësia
vetullat mbi syrin ulur
si nepërka nga zilia.

Kush të njohu dhe nuk deshi
të dëgjoi fjalë burri
si burime Kurveleshi
nisur nga Buronjë e Kuçit.

Sofo Labi ndaj të thonë
që në Kuç e për karshi
kush pi ujë në Buronjë
ujë Labërie pi!

Lëre këngën të burojë

"Një pseudorapsodi"

Ç'pate që më ngave vallë
o shelegari në këngë
mua kënga më mban gjallë
duhemi dhe jemi zënë.

Mua shpirtin të ma shtrydesh
kënga labe do burojë
dhe në burgje të m'i mbyllësh
dhe atje do dritërojnë.

Ato janë palcë e gjakut
ato janë palcë e shpuzës
këngës tënde i ka mbetur
vetëm qimet e lëkurës.

Pse më nget, o majë veshi
lëre këngën të burojë
është përdua Kurveleshi
po u nis s'di të ndaloj.

Kënga labe që të mbijë
do shkëmbinj me rrënjë thellë
nëpër arca s'di të rrijë
"do të tjera, o i mjerë?"

Ike ti, veri i lehtë

E mora buzëqeshjen tënde pranverore
e ndera mbi lulet e dheut
llirin e mora për dore
dhe sytë engjëjlore atje i ngjeu.

Gjiri i tij aq i brishtë
s'e mbajti dot aq buzëqeshje
ndaj morëm nga një çikë të gjithë
dhe viteve të jetës e mbajnë me vete.

Hëna e lodhur qiellit shëtit
agimet i bie të fishkur
qysh kur e sheh syri yt
drita e diellit është venitur.

Eh! Coku ynë si na ike?
si veri i lehtë e pa ndjerë
plagën tënde s'e shërojnë vitet
e dha Perëndia kaq të thellë!

Fryn një erë. . .

Dashurore, aq e shtruar
fryn një erë
Puhizore, aq lëmuar
më mbeshtjell.
Ledhatore, aq kërkuar
dot s'më vel.
Nuk më vel e s'do më velë
kurrë jo.
Do kërkojë, do më gjejë
kur më do.

Luten fushat përgjëruar

Dil, o lumi më të dalë
mbushe shtratin trubullirë
mbulo fushën anembanë
mbetur shkretë, mbetur djerrinë.

Mbetur shkretë, mbetur beronjë
vite pa çare ugari
pa zot nuk bëhet lehonë
cep më cep mbuluar bari.

Nuk sheh verdhëllimë gruri
as bardhëllime pambuku
limontinë kush e pruri
që të lidhë duart bujku?

I bëhet në ëndërrime
kur për të nuk kishte natë
s'kishte kohë të merrte frymë
sa lindte e mbarsej prapë.

Kur e përkëdhelnin lehtë
i njomnin buzën e tharë
i puthnin fletë më fletë
bimët që mbushnin hambarë.

Dil, o lumi më të dalë
luten fushat përgjëruar
s'janë ndryshe dherat tanë
nga dherat në vend të huaj.

Dhe ajo në lot kullon

Loti i bregut ra mbi valë
dhe valën e përvëloi
u mblodh pak e dalëngadalë
dhe ajo në lot kulloi.

I tha erës, fryj, moj erë
ashpër fryj e bëmë dallgë
nëntë ballë le të bjerë
t'i jap bregut ç'i kam marrë.

S'më shkojn përkëdhelitë
i bëj që t'i zbus inatin
e shpova sisë më sisë
varre ia qëndisa shtatin.

Lulet që më hedh mbi supe
e di që për mua s, janë
dhe pse janë aq të kuqe
sa rënkime brenda kanë!

Shkuma ime aq e bardhë
i kujton rrobat e zisë
ndaj s'e merr si dhe më parë
për vello të nusërisë.

Fryj, moj era tramundanë
hiqma sikletin të tërë
ç'kam marrë t'i nxjerr në anë
të ter dhembjet që kam dhënë!

Në Babicë i ka djepi

Gjysmë shtize rri bajraku
dhe loton.
Vlorë, moj zonjë konaku
si duron?
Robëzeza gjer në thua
më lëngon.
Atë lëndinë me lule
ku e çon?
Ku i shpie, u mbush deti
moj nën-o.
Zemra ime, atje mbeti
o bir-o
Ajo fusha në Babicë
pse rënkon?
Tetëdhjetë e ca një ditë
i mbulon.
Po ata që mbajti deti
moj nën-o?
në Babicë i ka djepi
o bir-o.

U pak kombi

U pak kombi duke ikur
përtej detesh e stëreve
u ngop bota së rrufitur
ajkën e ajkës së djemve.

U ngop deti, u ngop mali
me ata që s'kanë varre
ikën si shkëndijë stralli
dhe mbetën ligje për vaje.

Si u erdhi vdekja vallë
vdekja nuk ndryshon nga soji
ç'që fjalë e fundit që thanë
po kush vallë ua dëgjo?

U mpak kombi duke ikur
ç'të bëm, o Perëndi?
gjithë brezat të sfillitur
kaqë inat të madh ke ti?! . .

Xha Musait nga Saranda

Në lokalin "Labëria" xha Musai
në gota rakie i vak netët
tetëdhjet e dy vitet e tij
si kokra tespie në qafëdore mbetur.

Të gjithë na ngacmon, xha Musai
dhe vend na hap në zemrën e bardhë
ai që la pas lotin e mallit
puth shpirtin tonë kaq të vrarë.

Supet e tij furka në kasolle
luftojnë të mbajnë kalanë më të rënë
eh, koha e sertë hodhi flokë bore
dhe xha Musai nuk ç'të na bëjë.

Balada e Hodos

1.
I varfër ishte, Hodo Ziu
po ishte shakatar i madh
kur qeshte çiltër si çilimiu
e mbushte qytetin me gas.

Kur qeshte Hodua, dielli ndryshkej
dhe hidhte vështrimin me inat
të qeshurit e Hodos i ngjitej
dhe donte, s'donte, ndriste prapë.

Përvëlyshkej në gazin njerëzor
dhe shtriqej në lëkurën e dheut
për perëndimin nuk kishte orë
për lindjen zakonet, i theu.

Me diellin dhe Hodua perëndonte
dhe mbyllej brenda në shtëpi
dhomën e varfër ndriçonte
një vashë e bukur si perri.

Kish patur dhe ai një grua
të bukur, të heshtur si lastare
si lule u vyshk, si yll u shua
dhe dergjet tani në një varr.

Një amanet i kishte lënë
koha e dheut nuk e tret
t'i rritej bija si me nënë
si zanë u rite, Marjetë!

I vinte gruas te gjithnjë te varri
dhe lule mbillte nëpër saksi
Marjeta zhuritur nga malli
i vadit me lot nga ai sy.

Dhe babë e bijë kaluan vitet
u bë Marjeta shtatëmbëdhjetë
po kush vallë? Askush s'e dinte
do shpleksej jeta si një gërshtetë?

2.

Muzgu bie lehtë-lehtë
i pandier, dalëngadalë
lulja shtrin të gjelbrën fletë
një sy gjumë për të marrë.

Kthehen zogjtë krahëlodhur
sqepngarkuar në fole
zogthi i natës i përfolur
gjumëprishës pyllin ngre.

Rri Marjeta në dritare
syri mbrëmjen kalëron
mu si hëna lozonjare
që ngacmon yjet e shkon,

N'atë gushë qumështore
fladi veten e ndien mirë
me aq fjalë dashurore
asnjëherë s'kishte fryrë.

Ball'i gjirit i freskuar
atë shtat e drithëron
e qershitë, paduruar
ajo buzë flakëron.

Po atje ndënë dritare
një bandill i bilbilon
zbutu zogëz, pse xanxare?
je në moshë e s'dashuron!

Dil, o shpirt, e dil, o zemër
mbushma jetën ngazëllime
ato faqet t'i puth ëmbël
ata flokë trëndelinë.

Q'atë ditë që të kam parë
zemra ime rreh më shpejt
hidhet gjiri për të çarë
mblidhet e me vet flet.

Dhe kërkon në zemrën tënde
një çik'vend, aman një çik
e dëgjon që për ty çmendet

u kapit e u sfilit?

Eja t'ikim të dy bashkë
larg këtej prej varfërisë
në ato qytete jashtë
nder i bëhet bukurisë.

Ajte do shkëlqesh si yll
që të gjithë do të vështrojnë
tek ti do t'u mbeten syri
eh, o shpirt si do jetojmë?!

I dëgjon Marjeta fjalët
zverdhjet, skuqet në fytyrë
herë bëhet si limoni
herë shëgë, bëhet mirë.

S'kish dëgjuar ndonjëherë
fjalë që pa mend të lënë
ndaj një natë doli në derë
dhe dha ç'kish për të dhënë.

Fluturoi dallëndyshe
dashuria errur sytë
gjithë bota dukej ndryshe
edhe nata dukej ditë.

3.

U kthye Hodua shpatull-lodhur
portën e shtëpisë shtyrë ngadalë
krokëllima e saj aq e përlotur
bën që t'i flasë, bën që ta ndalë.

Krokëllima e saj e padëgjuar
kush e di në se sa vjet
zërin qyqes marrë hua
dot nuk hesht e gazin vret.

Gjëmëmadhja flet nxituar
ku vete sonte, o i mjerë?
për ty darka s'është shtruar
për ty, nxirosur është kjo derë.

Dy nga dy i kallon shkallët
Vështrim sterrosur e mat shtëpinë
bërtet e çirret si i shkalluar
ku je Marjet, ëngjëlli im?

Flokët mbërthen, me rrënjë i shkul
faqet i gris, trurin s'e ndal
kokën përplasë mur më mur
gjirin plagos, gardh e më gardh.

Zhurma e natës ndalet përgjon
heshtjen e çan mes e përmes
dita që lindi ende lehonë
druhet t'i flasë, druhet ta pyesë.

Dhe pyeti natën: -çka ndodhur vallë,
ç'i ke kurdisur, o e pabesë?-
tinëzarja fshihet si shtrigë e çalë
i murrëtyer vjen një mëngjes.

Qyteti hesht si i vulaksur
mbuluar veten me psherëtime
sheh Hodon të gdhirë plakur
dhe buzëqeshjen e tij të ngrirë.

4.

Drithëruar pret qyteti

krahu i natës ta mbulojë
thëllimore erë e detit
cingëros e s'do të shkoj.

E rrudhos faqen e dheut
e pashpirtë mbretëron
buzët akullore ngjeu
mbi qytetin me neon.

Blodhi retë, aq ngarkuar
u habit qyteti i vjetër
mbi Akropol kaq sterruar
s'ishte shtrirë natë tjetër.

Veç një zemër aq e vrarë
Nga një thikë majëzeher
pikon gjak e s'ka të tharë
pikon lot e kullon vrer.

E besoi dashurinë
lundroi në krahë të saj
e varrosi virgjërinë
në një çast dhe pastaj?

Pas një muaj e një ditë
në ekstazë, në delir
një pëllëmbë flakërimë
skuqi faqen, erri synë.

Zgavërruar rri bandilli
përmbi gjahun egërsirë
ëmbëlsira ikur filli
ardhur ngërçi në fytyrë

Do punosh i ulërinte
do punosh, thuaj 'dhulia'
është punë për njomishte
me fitime të mëdha.

E rrëmbeu si skifteri
pi nata dhimbjen e saj
gazi shterri, gjiri therri
tek lofata në një skaj.

Mallkoi ditën që lindi
mallkoi dhe dashurinë
atë ditë që e shiti
një i poshtër ne Athinë.

Ndaj s'ia ftoh ballin thëllimi
zemërimi e ndez shpuzë
eh, kjo natë , nga ta dini?
që do mpiks jetën në buzë.

5.

Atë natë Hodo Ziu, rri mendon
syri hapur diku mbetur, nuk vështron
thikë e heshtur, brenda gjirit, plagëron
gulç'i i lotit, kraharorin i shtrëngon.

Kokën varur, si për gjumë, po nuk flë
dita-natë, nata-sterrë është për të
i rrëgjuar, dorëdridhur, ndez cigare
lutet Zotit, lutet hidhur, që ta marrë.

Derëshuar, derëmbylluri me ferrë
lëmshi i jetës i mbaruar, s'ka ç'të tjerë. . .
orë e vdekjes, orë e fundit, pret t'i vijë
më të madhe kupë helmi, s'ka të pijë.

Ata zëra të përhapur, si beson
që Marjeta udhës flakur, kurvëron
dhe të qetë thirrje e gjakut , nuk e lë
ngrihet vrik e kalon pragun, udhën zë.

Fluturon mbi sup të erës, nëpër terr
i djersitur, s'ka të çlodhur, frymë s'merr
përplas ballin e gjakoset, mal më mal
lundron detesh nuk fundoset, del në anë.

I shpalosur i pagjumë, ai qytet
nata-ditë më shkëlqime, sytë i vret
i fërkon, aq të përsququr, me një dorë
shtrëgon fort re e ngarkuar bie borë

Flokërenda, pambukore, nuk pushon
gjithë gjindja ndërron ngjyrë, zbardhëllon
veç një dritë kuqërore, në një cep
derëhapur, aq mikluese, kë nuk pret.

I afrohet me ngadalë dhe përgjon
gjirëjashtë rri një vajzë, vjen e shkon
njohu flokët, dallgë e gjakut, zemrën plas
që nga brenda, aq i thekshëm, vjen një gaz.

S'ishte gaz, po ishte klithmë me llahtar
ç'i tha vashës Perëndia, ç'i tha vallë?
ulërima s'kish të prerë, nëpër terr
leshleshuar, faqeçjerrë, gjithë tmerr.

Dhe pas gjurmëve në borë, tek kish vdekur
gjeti Hodon dhe kulloi, ç'lot kish mbetur
puthi buzën që kish ngrirë, dhe u ça
për Marjetën më të mirë, vdekje s'ka.

6.

I varfër ishte Hodo Ziu
të bukur e kishte atë Marjetë
po fati s'ia la, vdekja i përpiu
një natë bore, larg në një qytet. . . .